

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ID-ENERGY” SHPK**

Ne Tirane, sot me date 08.11.2022 (dymije e njetzet e dy), u paraqitën personalisht ortaket themelues si më poshtë:

- 1- **Z. Erjon Kokoshi**, shtetas shqiptar, i biri i Luanit, lindur me 05.09.1982, ne Elbasan dhe banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit me Nr. I20905014J
Dhe
- 2- **Z. Endrit Kokoshi**, shtetas shqiptar, i biri i Kudretit, lindur me 14.05.1984, ne Elbasan dhe banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit me Nr. I40514085J

Te cilet hartojne kete Akt Themelimi te shoqerise “**ID-ENERGY**” SHPK, me emer tregtar “**ID-ENERGY**”, mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“ i ndryshuar, ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” i ndryshuar, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte:

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “**ID-ENERGY**” SHPK, me emer tregtar “**ID-ENERGY**”, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit(QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “**ID-ENERGY**” SHPK, eshte nje shoqeri, që themelohet ndërmjet ortakeve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Elbasan ne adresen Rruga "Dyli Haxhire", Pallati 3HS, 3001, Elbasan.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte:

Studim, projektim, ndertim, mbikqyrje, kolaudim per objektet e prodhimit, transformimit, transmetimit, matjes dhe shperndarjes se energjise elektrike ne rrjetat e tensionit te larte, te mesem dhe te ulet. Perfshire Hidrocentrale, Termocentrale, Parqe Eolike, Impiante Fotovoltaike, Nenstacione, Linja Transmetimi dhe shperndarje te energjise elektrike. Studim, projektim, mbikqyrje, kolaudim per ndertim e zbatim te veprave ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar. Studime urbanistike te te gjitha niveleve; planifikim urban; projektim arkitektonik; projektim strukturash mbajtese beton-arme, metalike; projektim rruges, autostradash, aeroportesh, heliportesh; vleresime mjedisore; projektim linjash dhe sistemesh se prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike; projektim ujësullës, kanalizime, vepra ujitje, kullimi, impiante vaditese, diga, dampa, etj; projektim vepra naftësullës, gazsullës, etj; projektim fotogrametrik, hartografik, topografik; konsulenca tekniko-ekonomike sipas kategorive dhe nenkategorive te licensave profesionale dhe cdo lloj studimi dhe projektimi, qe nuk permendet me sipër. Import esport i instrumentave mates dhe monitorues per gazra te ndryshem dhe emisionet te shkarkimit ne atmosfere. Tregtimit me shumice e pakice, import eksport te artikujve te ndryshem, ushqimore, industriale, elektrike, hidrosanitare, mekanike, etj. Import-eksport, grumbullim perpunim dhe tregtim i produkteve bujqesore, bimeve medicinale, veprimtari kreditimi e lizingu (qiraje) dhe ndermjetesime financiare, veprimtari ne fushen e transportit te mallrave dhe te udhetarëve, lokacione, blerje e tjetresime te pasurive te luajtshme e te paluajtshme. Ushtrim i veprimtarise financiare te faktoringut si subjekt jo financiar. Keshillime per bizneset mbi sherbimet bankare. Keshillime te sigurimit te llojeve te ndryshme. Keshillime per financime te ndryshme, modelim i biznesit. Keshillime per analize kontabel dhe tatimore. Keshillime mbi ristrukturimin e organizimin financiar, studime tregu, studime plan biznesi. Keshillime ne fushen e tatim taksave. Analiza per industri te ndryshme. Analizim i strukturave operative financiare. Keshillime financiare per performancen e kompanise ne treg ne krahasim me degen e industrise qe operon. Analiza dhe vleresim te biznesit. Keshillime mbi transaksionet e shitjeve dhe analiza per strategjine e shitjeve. Keshillime mbi partnershipe te ndryshme dhe negociime te termave te marveshjes. Keshillime mbi vleresimin e asetave te kompanive dhe te asetave njerzore. Asistime ne pergatitjen e raporteve vjetore. Vleresime risku dhe keshillime per mitigimin e tyre. Ristrukturime te bizneseve ne veshtiresi, keshillime dhe asistencë ne marredheniet me institucionet financiare, keshillime dhe bashkepunime me dhe per sektorin publik. Studime fizibiliteti.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise "ID-ENERGY" SHPK, eshte e pakufizuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000 lekë (NJE MIJE) , i ndare ne dy kuota.

- a) Ortaku z.**Erjon Kokoshi**, eshte zoterues i nje kuote me vlere nominale 500 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar.



- b) Ortaku z.**Endrit Kokoshi**, është zoterues i një kuote me vlerë nominale 500 leke, që përben 50% të kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 (tre) vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Mënyra të fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuota të kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a). kontributit në kapitali në shoqërisë;
 - b). shitblerjes;
 - c). trashëgimisë;
 - ç). dhurimit;
 - d). çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
1. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
 2. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
 3. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;

- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotavedhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin ne çfaredo banke apo institucion financiar.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator, **z. Erjon Kokoshi**, i cili sipas statutit dhe ligjit emerohet për një periudhë **5 – vjeçare** me të drejte ripërteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person jashtë ortakerisë.

Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha

shkalleve,prokurorive te te gjitha shkalleve,bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si perpara Bankave te gjitha nivele, per te kryer derdhje, terheqje, transferta etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punes, Autoriteteve Doganore etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12 Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 13 Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14 Dispozita perfundimtare

Ky akt u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejte juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare "ID-ENERGY" SHPK, dhe nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKET THEMELUES

TE SHOQERISE "ID-ENERGY" SHPK

ERJON KOKOSHI

Erjon Kokoshi


ENDRIT KOKOSHI

Endrit Kokoshi
